Në mbështetje të ligjeve të cituara me lart, Paketa fiskale e Bashkisë Prrenjas për vitin 2026 ka reflektuar ndryshimet ligjore por dhe përshtatjen e treguesve të taksave e tarifave vendore, ndryshimeve administrative, shtrirjes gjeografike dhe nivelit ekonomik të njesive administrative përbërëse të Bashkisë.
Të gjitha këto ndryshime do të shërbejne si instrument për rritjen e eficencës administrative, profesionale dhe teknike të qeverisjes vendore, nëpermjet rritjes së të ardhurave për t'i dhënë shërbime më të mira për qytetarët.
Paketa fiskale e Bashkisë Prrenjas për vitin 2026 është e përbërë nga taksa e tarifa vendore të distinuara për juridiksionin e kësaj Bashkie.

Nivelet e taksave vendore janë kryesisht të miratuara ne ligje nga Kuvendi i Shqipërisë, por për nevoja të qeverisjes vendore, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhe taksa të përkohshme apo tarifa, që i shërbejnë një objektivi të caktuar për përmirësimin e situatave në infrastrukturën e teritorit brenda juridiksionit të Bashkisë.
Për kuptimin me të saktë të materialit të referuar më poshtë, është e nevojshme dhe prezantimi i termave të saj si :

1. "**Baza e taksës**" është vlera mbi të cilën zbatohet taksa vendore sipas llojit të taksës ajo mund të kuptojë pasurinë, të ardhurat, çmimin ose vlerën e transaksionit.
2. "**Niveli tregues i taksës**" janë nivelet referuese të taksave vendore të parashikuara në ligj, mbi të cilat ka të drejtë të vendos Këshilli Bashkia në çdo vit buxhetor.
3. "**Taksë vendore**" është një pagesë e detyrueshme dhe e pakthyeshme në buxhetin e Bashkisë, e vendosur me ligj e miratuar në paketën fiskale, dhe që paguhet nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
4. "**Tarifë vendore**" është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejte të dhënë nga Bashkia.
5. "**Taksë ose tatim i ndarë**" është një taksë kombëtare ose tatim i përcaktuar sipas ligjit për procedurat tatimore ose ligjeve të veçanta tatimore, të ardhurat respektive prej të cilave ndahen, plotësisht ose pjesërisht, me njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
6. "**Të ardhura nga burimet e veta**" janë të gjitha të ardhurat që krijohen dhe administrohen në nivel vendor nën autoritetin e Bashkisë sipas legjislacionit në fuqi.
7. "**Agjent i taksave dhe tarifave**" është personi juridik/institucioni i cili është përgjegjës për arkëtimin dhe transferimin në llogarinë e Bashkisë së të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Në zërin " Taksa vendore ", konform ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, përfshihen llojet e tyre si më poshtë:

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin (Taksa e Biznesit te vogël)
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

a. Taksa mbi ndërtesat,
b. Taksa mbi tokën bujqësore,
c. Taksa mbi truallin,

3. Taksa e fjetjes ne hotel
4. Taksa e ndërtimit në infrastrukturë për Ndërtimet e Reja
5. Taksa e tabelës
6. Taksa të përkohshme